



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Florent Perjuci  
Pronar/Përfaqësues:  
“Kujtesa Net” Sh.p.k.  
OSHP K-Shqip  
Rr. Pashko Vasa Nr. 18  
Prishtinë

Ref: 1407/922/KPM/ni

## VENDIM

*për ndryshimin e emrit nga K-Shqip në K-Music si dhe ndryshimin e skemës programore*

### Fakte

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Ofruesi i Shërbimeve Programore (OSHP) K-Shqip, me seli në Prishtinë, është pajisur me licencë të KPM-së më datën 5 dhjetor 2008, për të vepruar si OSHP.
3. Komisioni i Pavarur i Mediave, më datën 7 korrik 2014, ka pranuar kërkesën e kompletuar të “Kujtesa Net Sh.p.k.”, në kuadër të së cilës funksionon Ofruesi i Shërbimit Programor K-Shqip, për ndryshimin e emrit nga K-Shqip në K-Music dhe të skemës programore të këtij Ofruesi të Shërbimit Programor, ndërsa me datën 11 korrik 2014 ka dorzuar edhe skemen programore me të cilën edhe ka kompletuar kërkesën e saj.

### Arsyetim

4. Kërkesa për ndryshimin e emrit të OSHP K-Shqip në OSHP K-Music është bërë për shkak të interesimit të licencuarit për ndryshimin e skemës programore, përmes së cilës i licencuari në fjalë planifikon të transmetojë vetëm program muzikor.

5. Emri i propozuar për OSHP K-Music, për t'u identifikuar në të ardhmen si OSHP në Republikën e Kosovës, nuk është i ngjashëm me asnjë nga emrat e të licencuarve nga KPM.
6. Komisioni konkludon që ndryshimi i emrit të OSHP K-Shqip në K-Music si dhe ndryshimi i skemës programore nuk paraqet ndërhyrje në politikat e transmetimit të KPM-së dhe është në pajtueshmëri me nenin 16.4 të rregullores 2007/04.

### Vendim

7. Komisioni merr vendim që OSHP K-Shqip t'i lejohet ndryshimi i emrit në K-Music dhe ndryshimi i skemës programore sipas propozimit të parashtruar.

### Lëshimi i Vendimit

8. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.

  
Adnan MEROVCI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



16.09.2014  
datë